

**VENDIM**  
**Nr. 139, datë 18.2.2015**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME  
TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE  
SHOQËRISË “PICARI”, SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “REPARTI I  
AXHUSTERISË ME TETOJËN DHE REPARTI I INSTRUMENTEVE, NË  
“ALBPETROL” SHA, PATOS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Picari”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Reparti i axhusterisë me Tetojën dhe Reparti i instrumenteve”, në “Albpetrol”, sh.a., Patos, me sipërfaqe të përgjithshme 9 800 (nëntë mijë e tetëqind) m<sup>2</sup>, nga ku 3 364 (tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) m<sup>2</sup> sipërfaqe nën ndërtesë.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**